

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, goditen disa grupe! 31 të arrestuar, 14 të tjerë në kërkim (VIDEO)
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/shisnin--prane-shkollave-ne-tirane-goditen-disa-grupe-31-te-arre-i516281
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 07:10:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 07:04:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	50e59a0d7ef552eba892dbea33e56dfc05c4c9037ed6dac81420d7aae2ea3bd5
TEKSTI	ff355eb53f69e38e6d38cadfbc31ae98874923879b5e70a2689c917e5e235000
PAMJA	63af49fd910fe15866a9fd1eb23e69051c90dde89efc3976e151937726bf5aed

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c388b57dda7a7c1978deff19152bea2c71bc16446fa9e2ecc1a52de4e15be53d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f5063896df89cef7c197e5d003e6be2f1d9963e4417c199c978c5a8c380b40e8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c388b57dda7a7c1978deff19152bea2c71bc16446fa9e2ecc1a52de4e15be53d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

12 ORE ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

14 ORE ME PARE

Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

18 ORE ME PARE

Ceremonia e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, Berisha: Nuk kam dijeni, në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare nuk jam ftuar

19 ORE ME PARE

Shpërthimi i fuqishëm në lagjen Plaka në Greqi/ Humbin jetën 6 persona, mes tyre dhe 3 shqiptarë të pajetë në rrënoja (EMRAT+PAMJET)

Aktualitet

Shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, goditen disa grupe! 31 të arrestuar, 14 të tjerë në kërkim (VIDEO)

Policia ka sekuestruar 1 kilogram e 75 gramë heroinë, 1 kilogram e 265 gramë kokainë, 685 gramë Cannabis Sativa, një pistoletë, 90 fishekë, 2 peshore elektronike, 12 automjete dhe 35 telefona celularë.



27 Shtator 2026, 09:04
Nga I.A



Pamjet

TIRANË- Disa grupe që shisnin lëndë narkotike pranë shkollave dhe në zona të ndryshme të kryeqytetit janë goditur ditën e sotme pas 4 muajsh hetime nga policia e Tiranës. Gjatë hetimeve janë identifikuar 52 persona, të cilët dyshohet se shisnin lëndë narkotike të llojeve të ndryshme. Për 31 prej tyre janë ekzekutuar masat e sigurisë "Arrest në burg", ndërsa 14 të tjerë janë shpallur në kërkim.

Policia ka sekuestruar 1 kilogram e 75 gramë heroinë, 1 kilogram e 265 gramë kokainë, 685 gramë Cannabis Sativa, një pistoletë, 90 fishekë, 2 peshore elektronike, 12 automjete dhe 35 telefona celularë. Sipas hetimeve, droga shpërndahej pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe në zona të ndryshme të Tiranës.



editoriale

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Në vëmendje

POLITIKE 26 SHTATOR 2026, 22:20

Eriseda Sefa e korrigjon këngën për Enver Hoxhën me Cllevion, reperi koncert falas në Lushnje

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 14:13

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve



Të arrestuarit me masën "Arrest në burg" janë G. J., 48 vjeç; E. B., 34 vjeç; E. O., 48 vjeç; B. K., 41 vjeç; E. V., 27 vjeç; D. Sh., 30 vjeç; A. K., 32 vjeç; E. H., 29 vjeç; J. N., 29 vjeç; Sh. Ç., 45 vjeç; E. H., 39 vjeç; E. M., 21 vjeç; F. P., 22 vjeç; K. M., 22 vjeç; R. T., 19 vjeç; K. M., 33 vjeç; I. D., 35 vjeç; F. Xh., 36 vjeç; B. M., 22 vjeç; I. A., 21 vjeç; A. L., 21 vjeç; S. A., 31 vjeç; E. T., 49 vjeç; A. P., 34 vjeç; V. M., 43 vjeç; D. M., 52 vjeç; E. P., 33 vjeç; N. Sh., 32 vjeç; A. K., 37 vjeç; T. A., 24 vjeç dhe V. R., 23 vjeç. Ndërkohë, 14 personat e tjerë të identifikuar nga hetimet janë shpallur në kërkim.

Njoftimi i Policisë:

DVP Tiranë Finalizohet pas 4 muajsh hetime, nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë në bashkëpunim me Prokurorinë e Tiranës, operacioni policor i koduar "SHKOLLA TË PASTRA". Goditen disa grupe që shisnin lëndë narkotike në afërsi të shkollave. Identifikohen 52 shtetas, pjesëtarë të grupeve, të cilët, të veçuar ose në grupe, shisnin lëndë narkotike, të llojeve të ndryshme, pranë shkollave dhe në zona të ndryshme të kryeqytetit. Ekzekutohen 31 masa sigurie "Arrest në burg" për pjesëtarë të grupeve.

Ndërkohë, vijon puna për kapjen e 14 shtetasve të tjerë. Gjatë periudhës hetimore janë arrestuar 7 shtetas. Gjatë periudhës hetimore dhe gjatë ekzekutimit të masave të sigurisë janë sekuestruar 1 kg e 75 gramë heroinë, 1 kg e 265 gramë kokainë, 685 gramë Cannabis Sativa, 1 armë zjarri pistoletë, 90 fishekë, 2 peshore elektronike, 12 automjete, 35 telefona celularë dhe sende të tjera të kundërligjshme. Në kuadër të operacionit të koduar "SHKOLLA TË PASTRA", u ekzekutuan masat e sigurisë "Arrest në burg" për 31 shtetas dhe konkretisht:

G. J., 48 vjeç; E. B., 34 vjeç; E. O., 48 vjeç; B. K., 41 vjeç; E. V., 27 vjeç; D. Sh., 30 vjeç; A. K., 32 vjeç; E. H., 29 vjeç; J. N., 29 vjeç; Sh. Ç., 45 vjeç; E. H., 39 vjeç; E. M., 21 vjeç; F. P., 22 vjeç; K. M., 22 vjeç; R. T., 19 vjeç; K. M., 33 vjeç; I. D., 35 vjeç; F. Xh., 36 vjeç; B. M., 22 vjeç; I. A., 21 vjeç; A. L., 21 vjeç; S. A., 31 vjeç; E. T., 49 vjeç; A. P., 34 vjeç; V. M., 43 vjeç; D. M., 52 vjeç; E. P., 33 vjeç; N. Sh., 32 vjeç; A. K., 37 vjeç; T. A., 24 vjeç dhe V. R., 23 vjeç.

Gjatë fazës hetimore janë ndaluar dhe 7 shtetas të tjerë, konkretisht shtetasit K. C., G. M., Zh. P, E. T., D. Sh., D. F. dhe M. T. Ndërkohë, 14 shtetasit e tjerë të identifikuar nga hetimet, si pjesë e këtyre grupeve, janë shpallur në kërkim dhe, për arsye se hetimi vijon, nuk bëhen me dije gjeneralitetet e tyre. Vijon puna për kapjen e tyre dhe për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale. Nga hetimet është dokumentuar se këto grupe shisnin lëndë narkotike pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme dhe në zona të ndryshme të Tiranës.

Në disa raste, për të shmangur vëmendjen e shërbimeve policore në terren, lënda narkotike shpërndahej nëpërmjet monopatinave, si dhe shërbimeve taxi dhe delivery. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme. Policia e Tiranës është e fokusuar maksimalisht në garantimin e sigurisë në shkolla dhe në luftën ndaj fenomeneve kriminale, si dhe siguron prindërit dhe qytetarët se do të intensifikojë kontrollet dhe hetimet për parandalimin dhe goditjen e çdo veprimtarie kriminale që cenon sigurinë e nxënësve./Dosja.al

aksion ne tirane

Sondazh

Poll

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:36

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtar i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës

më të klikuarat

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtar i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës

Aksioni i SPAK kundër grupit Rraja/ Shkon në 17 numri i të dyshuarve, Indrit Dokle i akuzuar për trafik ndërkombëtar droge

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve

Zbardhet plagosja e djeshme në Tiranë/ Identifikohet dhe shpallet në kërkim autori! Në pranga edhe i dëmtuari pasi kërkohet në Kosovë (EMRAT)

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow.

Aktualitet
27 Shtator 2026, 08:48

Aksident tragjik në Maliq/ Po nxirrte rrobat nga bagazhi, makina rrëshqet dhe e zë poshtë

Policia MALIQ- Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Maliq, ku një 43 vjeçar ka ndërruar jetë p...

Tiranathlon, kufizohet qarkullimi në disa akse të Tiranës

Aktualitet
27 Shtator 2026, 08:16

Kthjellime dhe vranësira, parashikimi i motit për sot

Aktualitet
27 Shtator 2026, 07:30

FOTOLAJM/ "Arrestoni Ramën" dhe "Prangat e përkohshme, historia e përhershme", pankartat që tërhoqën vëmendjen në "Air Albania"

Aktualitet
26 Shtator 2026, 22:50

"Nesër më shumë" / Mbyllet protesta e 119-të: Ju erdhi fundi!

Aktualitet
26 Shtator 2026, 22:30

Aktualitet
26 Shtator 2026, 22:16

Tensionohet situata/ Protestuesit çajnë kordonin e policisë dhe viiojnë marshimin: Rama iene

dorëheqjen

Pamje TIRANA- Protestuesit kanë çarë kordonin e policisë dhe kanë vijuar marshimin. Gjatë marshimit të Liqeni Artificial, p...

"Arrestoni Ramën"/ Thirrjet kundër kryeministrit, protestë edhe në "Air Albania"

Aktualitet

26 Shtator 2020, 22:11

Marshimi i protestës/ Policia i bllokoi rrugën qytetarëve pranë Liqenit Artificial, shkak ndeshja në 'Air Albania'

Aktualitet

26 Shtator 2020, 21:57

Dita e 119-të e protestës/ Vijon marshimi i qytetarëve në Tiranë: Pa rini nuk ka Shqipëri

Aktualitet


26 Shtator 2020, 21:50

Tragjedia me 6 viktime në Athinë, reagon Ministria e Jashtme e Shqipërisë: Ndajmë pikëllimin e familjeve të prekura

Aktualitet

26 Shtator 2020, 21:20

MË SHUMË



Kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare



Kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

Berisha i uron mirëseardhjen ambasadorit të ri: SHBA do të japë një ndihmë substanciale

Berisha: Provat direkte më të mëdha i kam për Edi Ramën, por SPAK nuk guxon ta thërrasë

Berisha: Ai është armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër Vetëvendosjes

Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDËSIJAR NGA  Mediodesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.